



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 27

Datë: 08. 06. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
 2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;
 3. Aktivitetet e ZRPP-së;
 - Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve;
 4. Raporti i këshillave të KQZ-së
 - Këshilli i Operacioneve Zgjedhore;
 - Ndarja e pozitave të anëtarëve të KVV –ve në Vendvotime;
 - 5.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndalimin e fotografimit të votës gjatë votimit.
 6. Të ndryshme;
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur ne mbledhjen e 27 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve! A ka dikush vërejtje në pikat e rendit të ditës? Po urdhëro, Ilir...?

Iir Gashi: Faleminderit nëse me lejohet që të propozoj tek raportimi i këshillave një raport lidhur me këshillin për informim publik. Me shtuar si pikë e rendit të ditës.

Valdete Daka: Faleminderit! Kush është për këtë rend dite, me këtë pikë shtesë? Mirë.

Komisioni miratoi rendin e ditës.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër, aktivitet e sekretariatit. Urdhëro!

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor

EnisHalimi: Tashmë, jemi thuajse në përfundim të pajisjes me, dhe liferimit të të gjitha materialeve zgjedhore. Mund ta shihni nga raporti, është thuajse në përfundim dhe pritjet sot të përfundoj shtypja e listës së votuesve të cilën nesër do ta kemi në depo. Për sa i takon operacionit të votimit përmes postes, deri më tani kemi pranuar 1289 pako me fletëvotime. Për sa i takon regjistrimit për votim të personave me nevoja të veçanta, kjo periudhë ka filluar nga 25 deri me 28 maj. Dhe, komisionet komunale, gjatë kësaj periudhe, kanë pranuar të dhënat e votuesve, të cilët i keni të shfaqur në tabelë në faqen numër 2 dhe 3. Po ashtu, po bëhen edhe përgatitjet që t'u ofrohet mundësia e votimit të gjitha kategorive që parashihen me rregullativen ligjore, sikundër janë ata në qendra korrektuese, në qendra të paraburgimit, pra në burgje.

Edhe procesi i trajnimit të komisionereve apo të anëtarëve të këshillave të vendvotimit, tha z. Halimi, është duke vijuar sipas dinamikës së paraparë. Po ashtu, edhe materialet e tjera zgjedhore të cilat kemi raportuar dje që jemi në pritje të tyre tashmë janë në depo dhe nuk kemi ndonjë telashe në kuptim të vonesës së tyre apo edhe të cilësisë, për shkak se po bëhet procesi i vazhdueshëm i kontrollimit të cilësisë të secilit material, në mënyrë që të sigurohemi se do të dalim mirë në ditën e zgjedhjeve. Pra edhe cilësia, deri me tash, e atyre materialeve që janë testuar, po e theksoj edhe një herë, spreja, llampa, bateria e kështu me radhë, është cilësia e garantuar, cilësi e dëshmuar dhe nuk ka arsye për t'u brengosur. Për sa i takon QNR-së, atje po vazhdon trajnimi i stafit ditorë dhe stafit që do të jetë i angazhuar në projektin K-VOTE. Po ashtu, deri me tash janë trajnuar rreth 600 persona, dhe deri me tash ka përfunduar procesi i trajnimit të stafit K-VOTE, që përfshinë afër 800 persona. Dhe, për nesër, nga QNR-ja parashihet që të bëhet një proces i simulimit të procesit që do të zhvillohet atje pas datës 11. Faleminderit!

Valdete Daka: Faleminderit! Po Betim...!

Betim Gjoshi: I kam dy çështje me i diskutuar: njërin prej tyre e paraqita në raport. Ne, kemi marrë një vendim në mbledhjen e kaluar që me i marrë disa masa për numërimin e saktë të votave për subjekte dhe kandidatët, rritjen e transparencës gjatë votimit. Ndoshta, është mirë me na dhënë përgjigje krye shefi se deri ku ka shkuar zbatimi i saj? Na ka thënë që do të ketë gjatë ditës së nesërme trajnim shtesë me kryesues të këshillave të vendvotimit. E dyta: ne, siç e dini, i vlerësojmë rreziqet që mund t'i kemi ditën e zgjedhjeve si KQZ, anë e mbanë Kosovës, dhe është mirë që deri nesër me pas një njoftim lidhur me rreziqet e mundshme që mundën me u shfaqë ditën e zgjedhjeve duke u bazuar në informatat që posedojmë deri me tani, përfshirë edhe sigurinë dhe të gjitha çështjet tjera, me qëllim që ne të jemi të përgatitur për çdo vendimmarrje si KQZ. Përndryshe, nëse puna është vetëm kështu siç e keni shënuar në këtë raport, atëherë unë jam i kënaqur me përgatitjet që keni bërë. Ju përgëzoj! Kjo çështja e votimit jashtë vendit për mu është më shqetësuese, sepse kemi numër shumë pak të pranuar në krahasim me të

regjistruarit. Vetëm 10% nga ata kanë aplikuar deri me tani, por ndoshta kanë kohë. Kjo bazohet në informatat e ditës së djeshme, jo të sotit. Ndoshta, sot e nesër mund të ketë ardhje të tjera...

EnisHalimi: Për sa i takon çështjes së parë që u ngrit, që ka të bëj me masat që kemi ndërmarrë për atë. Tashmë jemi në proces të implementimit të asaj që jemi dakorduar dhe çka është vendosë në mbledhje të KQZ-së. Pra, është plotësuar deklarata. I është hartuar shkresa përcjellëse e cila do të përcillet me nënshkrimin e kryetares. Do të përcillet sot gjithë kryesuesve që do ta zhvillojnë trajnimin nesër. Dhe, po ashtu edhe posteri me nenet e kodit penal që lidhet me shkeljet për veprat që kanë të bëjnë me zgjedhjet është në shtyp. Këto janë aktivitetet që i kemi ndërmarrë në drejtim të realizimit të vendimeve, apo te ekzekutimit të vendimeve që janë marrë këtu. Po ashtu, ne jemi në kontakt të afërt me organet e sigurisë që ta “përthekojmë” procesin zgjedhorë nga ai dimension, në mënyrë që të mos i lejmë asgjë rastit. Në çdo indikacion të mundshëm ne do të shkëmbejmë informata reciprokisht me organet e rendit, dhe aktivitetin tonë e riformatojmë konform informatave dhe inputeve që kemi. Faleminderit!

AdnanRrustemi: Së pari, e kam një çështje me e ngritë, që lidhet me shërbimin votues. Me informimin e votuesve ku do të votojnë. Ka shqetësime që ngritën për ndryshimet e vendvotimeve. Natyrisht që ne kemi parasysh që gjatë kësaj periudhë edhe kanë mundur më ndryshuar të dhënat mbi adresën për votues të caktuar. Por, problemi është se, ajo çka e ka ndërlikuar procesin e informimit të votuesve përmes makinës kërkuese është se si asnjëherë më parë, përkundër që unë e vlerësoj gatishmërinë e sekretariatit për ta rritur sigurinë e të dhënave që publikohen në ueb faqe, në mes të periudhës së shërbimit votues, jo nga dita e parë, është vendosë një mekanizëm i sigurisë kinse të qasjes, po e quaj në makinën kërkuese. Ideja e atyre mekanizmave mbrojtës të ueb faqeve, etj. Por, kjo po ndikon negativisht në qasjen në informim për me u identifikuar votuesi. Ideja që të shfaqen aty në gjuhën angleze mekanizmat, pastaj identifikimi i fotografive për të mundur ta kuptojmë një kuiz, pikërisht kuiz për votuesit në gjuhën angleze është tepër vështirë për të thënë po bëhet e pa mundur qasja në një informacion që është thjesht bazik ku e kanë qendrën e votimit.

Për mua, tha z. Rrustemi, ka pasur një kuptim ky mekanizëm që e kemi vendosur në periudhën e ndërrimit të qendrës së votimit për ta penguar eventualisht qasjen e të tjerëve për me ju ndryshuar qendrën e votimit votuesve të tjerë pa vullnetin e tyre, për kundër që u kërkua kopja e letërnjoftimit po tashmë që ka përfunduar kjo periudhë unë personalisht kërkoj që me largu këtë mekanizëm dhe me ju lehtësuar votuesve sidomos në këto 2-3 ditë ku edhe interesimi do të jetë shumë më i madh për tu informuar ku e kanë qendrën e votimit, edhe trupat tona do ta kenë të domosdoshme qasjen në këtë mekanizëm për të ju gjetur votuesve vendvotimin kështu që nëse është e mundur sa më parë brenda ditës largojeni këtë pengesë sado me qellim të mirë por që po ju pamundëson votuesve për ta identifikuar qendrën e votimit, këtë kisha. E dyta, po më intereson në cilën ditë do të bëhet shpërndarja në depot komunale të materialit të ndjeshëm dhe a do të ketë probleme se e dimë që probleme në shpërndarje po flas, në përgatitje në nivel të KQZ-së për shpërndarje. E treta, është këta votuesit në institucione dhe në qendrat tjera që janë regjistruar të merren masa nga sekretariati që në përputhje me rregullativen trupa tona t'i vulos këta emra që bëhet me dije që kanë mundësi me votuar vetëm përmes ekipeve mobile tashmë, por jo emrat e tyre në vendvotime të jenë të shënjuar në, për, pamundësi votimi në vendvotim. E katërta, për këtë çështjen e votimit jashtë vendit është e vërtetë që është shqetësues numri i fletëvotimeve ose i pakove me fletëvotime të ardhura. Megjithatë, po shpresoj që këto 2 dit, deri të shtunën, do të ketë ardhje të reja, por megjithatë është mirë ta vendosni një komunikim më qendrën e regjistrimit të dërgesave të Postës së Kosovës, që me u siguruar që nuk ka asnjë dërgesë që mbetën në këtë gjendjen tranzitore deri në... KQZ-së para se të mbyllet afati.

Betim Gjoshi: Rreth kësaj çështjes të makinës kërkuese është mirë që, besoj të gjithë pajtohemi, nëse nuk e pengon teknikisht është mirë me larguar sot. Sa më shpejtë që është e mundur sepse me të vërtetë është

sfidë, sidomos për ata që provojnë prej një pajisje elektronike më shumë se dy herë me kërkuar, i'u nxjerrë shumë vështirësi ky kuiz për me mbërri deri te ajo. Mendoj që ne e kemi pasur edhe në të kaluarën, dhe s`kemi pasur asnjë ankesë prej dikujt që i ka nxjerrë probleme, si në mbrojtje të dhënave si në çështje tjera. Për pjesën tjetër ndoshta na jep përgjigje?!

EnisHalimi: Faleminderit! Për sa i takon votuesve nëpër institucione, ne jemi duke i zhvilluar procedurat, duke i bërë verifikimet e nevojshme që garantojnë integritetin e procesit zgjedhorë. Në këtë plan, edhe ajo që u ngrit këtu është duke u proceduar si e tillë. Pra jemi në kontakte edhe me zyrtarët tonë, qoftë në sekretariat, qoftë me kryesuesit të komisioneve komunale zgjedhore, është duke u bërë. Për sa i takon shpërndarjes së materialit sensitiv a do të kemi probleme nuk e dimë, por ne nuk parashohim deri tash ndonjë problem si pasoj e ndonjë deficiti që ne aktualisht kemi evidentuar përveç ndoshta materialit të ndjeshëm që janë fletëvotimet të cilat ende nuk kanë arritur në depon tonë. Gjitha materialet e tjera që kanë karakter të ndjeshëm dhe po ashtu ato të pandjeshëm ne i kemi në depo dhe kemi mjete logjistike të mjaftueshme për ta bërë transportin e tyre në mënyrë efikase në gjithë territorin pra në gjitha komunat, gjitha depot komunale nuk parashohim komfort asaj qysh veprohet me materialet e ndjeshme pranojmë përcjellje të forcave të rendit dhe nuk është se parashohim ndonjë telashe në këtë drejtim. Për sa i takon kësaj, kjo do të hiqet sot nëse është dakord kështu e përgjithshme hiqet tash për shumë pak minuta ndoshta brenda orës do të largohet ajo. Por ka qenë siç u tha këtu ka qenë në funksion të integritetit që mos të manipulohet e kështu me radhë, faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit, nëse nuk kemi pika të tjera (po mendoj çështje tjera për diskutim) lidhur me këtë pikë vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-së.

3. Aktivitetet e ZRPP-së;

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve

Mirdaie Mavriqi: Faleminderit kryetare, të nderuar anëtar të KQZ-së ju njoftojmë se deri me 7 qershor zyra ka procesuar aplikacionet e 37 organizatave që kanë aplikuar për akreditim dhe vëzhguesit e 1 ambasade, 8 partive politike, 5 koalicione, 5 organizatave jo-qeveritare vendore, 1 organizatë ndërkombëtare, 15 media, 2 institucione shtetërore me gjithsej 3,873 vëzhgues. Janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara komfort ligjit të nenit 44 dhe 45 të ligjit për zgjedhjet e parakohshme dhe përgjithshme si dhe nenit 3 të rregullës zgjedhore 07 2013 dhe zyra rekomandon akreditimin e këtyre organizatave të cilat emrat e organizatave dhe numrin e vëzhguesve e keni të bashkangjitur në rekomandim, ju faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit drejtoresh, i kemi para jush emrat në CD ndërkaq i kemi emrat e institucioneve, organizatave të cilat kanë aplikuar në afat dhe numrin e vëzhguesve me cilin kanë aplikuar ata për akreditim. Kush është për akreditimin e këtyre personave, faleminderit.

AdnanRrustemi: A bën veç një pyetje, a është e fundit a do të kemi ende se po na intereson ta dimë përmbylljen, rrumbullaksim për procesin.

MiradieMavriqi: Janë zyrtarët që janë duke bërë kontrollimin edhe afër 1,000 më duket ashtu.

Valdete Daka: Kur ta përmbyllim me siguri që do të kemi me pas një raport me numrin e saktë dhe me institucionet që kanë aplikuar. Vazhdojmë me pikën tjetër...po

Betim Gjoshi: Kryetare të paktën e di që vetëm një OJQ-së janë edhe 4,000 në verifikim, për atë saktë është informata mbi 5,000 vetë.

MiradieMavriqi: Kërkoj falje. Atëherë sa jam e njoftuar me 1000...

Valdete Daka: Vazhdojmë me raportin e këshillave: Këshilli për operacione zgjedhore.

4. Raportet e Këshillave të KOZ

Këshilli i Operacioneve Zgjedhore

Ndarja e pozitave të anëtarëve të KVV –ve në Vendvotime

AdnanRrustemi: ...Në fakt, këshilli për operacione zgjedhore nuk e ka trajtuar këtë shkresë. Bëhet fjalë për formulën e ndarjes së pozicioneve brenda këshillave të vendvotimeve. Unë e ftoj krye shefin që ta prezantoj. E diskutojmë ose e plotësojmë, ose prezantohet nga zyrtari përkatës...!

Betim Gjoshi: Është një praktikë që zakonisht po e ndjekim çdo palë zgjedhje. Mendoj që, kësaj radhe kemi ndonjë specifikë edhe më shumë se herën e kaluar, sepse i kemi të grupuar komisionarët kryesisht në dy koalicione të mëdha dhe një subjekt tjetër, parti politike. Mendoj që ka qenë edhe propozim i mëhershëm i KOZ-së që askujt të mos i lihen dy pozita radhazi, dhe askujt të mos i lihen dy pozitat kryesore që janë në vendvotim, dhe mendoj që është bërë një zgjidhje e tillë. Për mua është në rregull. Nëse nuk ka dikush me plotësuar, atëherë.

Valdete Daka: E kemi para vetes formulën dhe udhëzuesin.

AdnanRrustemi: Unë prita që po e sqarojnë, por për mua tabela është në rregull, por teksti nuk korrespondon me tabelën mjaftueshëm. Teksti i shkresës është thujse teksti i shkresës së zgjedhjeve të mëparshme, ku flet për ndarje proporcionale, por në asnjë rast nuk e thekson që kërkesën e vazhdueshme të KOZ-së, ose të mbledhjeve të kaluara, që ndarja me qenë e tillë që asnjë subjekt mos me i pasur pozicionet as të ngjitura brenda këshillit të vendvotimit, as pozicionit që korrespondojnë në komunikim me njëra tjetrën për me ndikuar në proces. Në tekst nuk thuhet që kjo në tabelë është... Unë kisha kërkuar që përmbajta e tabelës me u reflektuar në tekst. Asgjë më shumë.

Ilir Gashi: E miratojmë tabelën, pastaj teksti shkruhet sipas tabelës.

EnisHalimi: Teksti harmonizohet me tabelë, me këto plotësime që u dhanë.

Valdete Daka: Teksti është në rregull sipas të gjithëve. Atëherë kush është për aprovimin e kësaj table? Natyrisht teksti të harmonizohet dhe të inkorporohet.

Komisioni miratoi tabelën me këto plotësime.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër. Me këshillin për informim. Urdhëro, Ilir!

Këshilli mbikqyrës për Informim Publik

Ilir Gashi: Faleminderit, kryetare! Materialin e keni para vetes. Do të mundohem në pika të shkurtra me dhanë një pasqyrim rreth punës së këshillit për informim publik. Këshilli pothuajse ka përfunduar punën e vet rreth informimit publik. Në mbledhjet e fundit, sidomos që i kemi mbajtur shihet që TV dhe Radio Spotet të cilat i kemi miratuar se si të plotësohet fletëvotimi është bërë në 5 gjuhë. Pastaj, TV dhe Radio

spotin hapat në vendvotim, gjithashtu është në 5 gjuhë. TV dhe Radio spotin motivues, po ashtu në 5 gjuhë. Radio spotin motivues për të rinjtë në dy gjuhë, dhe me titra në gjuhën boshnjake, rome dhe turke. TV dhe radio e KQZ-së në dy gjuhë dhe me titra në gjuhën boshnjake, turke dhe rome. TV dhe Radio spotin çka ndodhë me fletëvotimin, në 5 gjuhë. Media planet për transmetimin në TV dhe radio spotet në KTV, 21, RADIO 21, RADIO DUKAGJIN dhe RADIO PLUS. Po ashtu, TV dhe Radio spotet si te plotësohet fletëvotimi për të rinjtë në KQZ, janë duke u transmetuar në RTKS, KTV, 21, RADIO 21, RADIO KOSOVA, RADIO DUKAGJIN. Vlen të theksohet një çështje e cila, kemi hasur në një problematikë të vogël në një radio lokale, siç është radio Gracanica. Është ndërprerë transmetimi për faktin, më kërkesën edhe tonën, pas informimit nga kompania sepse ka kërkuar që gjatë informimit të hiqet aty ku ka mbishkrim dhe ku përmendet Republika e Kosovës. Dhe, ne duke mos e pranuar këtë kërkesë kemi provuar që t'i dërgojmë në radio tjera lokale. Kjo ka ndodhur kështu sipas rekomandimit tonë. Gjithashtu, edhe informimet i kemi bërë rreth ndryshimit të qendrave të votimit në mbledhjen e fundit. Njoftimet rreth qendrave të votimit që kanë filluar dhe janë transmetuar edhe në RTK. Natyrisht nga data 02.06., kur ka filluar. Dhe, për lokacionet apo për komunat, si në Rahovec, Shtime, Ferizaj, Leposaviq, Vushtrri dhe Zubin Potok. Ne, do të i`u paraqesim edhe një raport të detajuar sa i përket informimit publik çka ka ndodhur gjatë gjithë kësaj periudhe, në mbledhjet e radhës. Faleminderit shumë!

Betim Gjoshi: E para, desha me ngrit një çështje. Ne, tashmë si shoqëri jemi duke shfrytëzuar mjaft shumë portalet dhe rrjetet sociale. Por, unë e kam parë që janë të mangët edhe pse në strategji e kemi pas miratuar si Komision Qendror Zgjedhor që me pas me qen prioritet i inovacionit që ka pru teknologjia. Nuk po e shoh në portale, të paktën këto që i shfletojmë, kryesoret...Unë, ende nuk kam parë informimin... Nuk po e shoh as në raport, dhe është mirë ta kemi parasysh këto ditët e fundit me vazhduar me këtë pjesën edukuese rreth pjesës së votimit. E dyta, po ashtu, mendoj që duhet me u rrit terminet, apo nëse ka minutazhë ende te kjo kampanja e informimit publik. Të shtohen reklamat për mënyrën e votimit...! Ne, po i kemi deri në 20, deri në 40 000 mijë fletëvotime të pavlefshme. Çdo palë në zgjedhje, është mirë të punoj që qytetarët me qen të edukuar për mënyrën e votimit, dhe me qen sa më i shpeshtë ai spot në termin kur është i shikuar prej njerëzve. Këto janë dy kërkesat që kisha pas: qoftë me i përfshi njerëzit që janë në kontakt me këto punë...

Ercan Spat: Ju faleminderit. Unë, nëse jam gabim (përmirësomëni), mendoj se si çështje parimore është nëse do të kemi një raport të këshillit, çfarëdo raporti...Duhet të aprovohet në këshill, apo të dilet paraprakisht, se a janë informuar anëtarët e këshillit. Mandej, unë si anëtar i këshillit këtë raport e shoh si informim i KQZ-së, informim paraprak. Raporti detal, duhet të kaloj nëpër procedurat e duhura...

Illir Gashi: Unë, qysh në fillim thash se ky është një informim sa i përket asaj se çfarë ka ndodhur. Dhe ne, do ta bëjmë raportin përfundimtar i cili pastaj, do të kaloj edhe nëpër këshill, dhe do të miratohet në këshill.

Valdete Daka: Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër nëse nuk kemi diçka tjetër, vazhdojmë me pikën tjetër... Urdhëro, kryeshef!

5.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndalimin e fotografimit të votës gjatë votimit.

Enis Halimi: Faleminderit, pra para jush ajo çfarë kisha me theksuar ka të bëjë me një si të themi dukuri e cila ka qenë preokupim dhe shqetësim i yni edhe në të kaluarën për të cilën kemi, KQZ-ja ka vendos që të ketë simbolin e ndalimit të fotografimit të votës. Ndoshta në rend dite do të duhej dhe në vendim të

bëhej një përmirësim në kuptimin që ti përshtatet gjuha e pikës së rendit të ditës dhe për rrjedhojë edhe e pikës së rendit të ditës ndoshta të kemi një harmonizim të mirë me rregullativen, por kjo është tashmë si procedurë e zakonshme e cila është tashmë para jush.

Betim Gjoshi: Unë gjithsesi që përkrahi që shenja edukuese me u ngjit. Është mirë të përgatitet në gjuhët sipas ligjit për gjuhë që mos të kemi ndonjë problem edhe është mirë që me atë punë. Edhe është mirë që të ngjiten me kohë në vendvotim ose para vendvotimeve ku i vendosni edhe shenjat tjera, edhe e dyta vendimi është mirë që mos të krijoj një procedurë të re ligjore por të jenë në përputhje me rregulloren për numërim dhe votim që e kemi në kuadër të Komisionit Qendror Zgjedhor me ligjin për zgjedhje, edhe me kodin penal me nenin e caktuar që ka të bëjë me cenimin e fshehtësisë së votës. Ndërlidhet me këto dhe në pajtim me këto duhet të jetë edhe teksti i vendimit mos të na krijoj një rregullativë të re. Faleminderit!

Adnan Rrustemi: Edhe unë pajtohem, veç se kisha kërkuar sekretariatit që gjatë komunikimit trupa mos ta interpretoj këtë vendim si ndalin po e zëmë të përdorimit të telefonave nga trupat e administrimit të zgjedhjeve kur bëhet fjalë për fotografimin e formularëve të përputhjes së rezultateve dhe të kandidatëve, sepse ja kemi njohur këtë të drejt si vëzhguesve të pranishëm si komisionerëve që në fund të ditës në pa mundësi për ti ofruar kopje të kenë mundësi ti fotografojnë FPR-në dhe FRK-në.

Betim Gjoshi: Ne, e kemi shpjeguar këtë çështjen e filmimit çfarë lejohet çfarë nuk lejohet, nuk lejohet votuesit për të fotografuar nxirrni mundësisht është mirë mos të krijojnë 100 rregullativa, sepse kemi hutuar këshillat e vendvotimit dallimet pi bëjmë i kemi dërguar doracak e kanë një rregullore po ju dërgojmë edhe 10 udhëzime ata mundën me të ngarkohen në ditën e zgjedhjeve vetëm ti lexojnë e kanë problem, jo vetëm t'i implementojmë.

Valdete Daka: Edhe me i harmonizuar, nëse rastësisht nuk janë. Gjithsesi ne po e aprovojmë, ndërkaq të harmonizohet me këto që thamë. Kush është për? Edhe me ligjin mbi përdorimin e gjuhëve në Kosovë. A kemi diçka tjetër?

Bajram Ljatifi: E dëgjuam një informatë nga Këshilli për Informim, dhe puna që është bërë të bëhet sa më aktive, Sekretariati të njoftojë...

Valdete Daka: I kemi dërguar të gjitha në qendrën. Qendra mediale do të hapet nesër zyrtarisht. Atje do t'i kemi edhe takimet, edhe informimet për media. Pra, atje do t'i bëjmë të gjitha. Do të kenë mundësi edhe gazetarët me u kçuçur direkt dhe me i përdorë të gjitha mundësitë elektronike.

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës me ndryshimet e sugjeruara

6. Të ndryshme

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
